



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:271554

Datë: 21.02.2023

Numri i dokumentit: 03997393

PKR Nr. 17/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Krimeve të Rënda, Kryetari i trupit gjykues Murat Hulaj, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Alan Taranish, në çështjen penale kundër të pandehurit H. Sh., për shkak të veprës penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 414 par. 1 të KPRK-së, e duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti i krimeve të rënda nën shenjen PP/I Nr. 320/22 dt. 25.01.2023, pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit fillestar me dt. 16.02.2023, në prezencën e Prokurores së Shtetit Valbona Disha Haxhosaj, të pandehurit H. Sh. dhe mbrojtësit e tij av. Haxhi Sinanaj, të njëjtën ditë morri dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. 21.02.2023 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

H. SH., i biri i J. dhe i nënës H., e gjinisë B., i lindur me dt. ..., ne I, me banim në rr. “ M” nr. ..., fsh. K., K. I, i martuar, baba i katër fëmijëve, ka te kryer fakultetin e Edukimit, me profesion ish Drejtor në Drejtorinë Komunale të Arsimit në I., tani kontabilist, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. ..., posedon telefon me nr. 049/...-..., i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, gjendet ne liri,

ËSHTË FAJTOR

Për shkak së:

Me datë 30.09.2021, në I., i pandehuri në pozitën e personit zyrtar si Drejtor i Drejtorisë Komunale të Arsimit në I., duke shfrytëzuar autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për tjetrin dhe atë për mësimdhënësen A. B., ku e njëjta në bazë të listës së pagave ka përfituar pagë mujore neto në shumë prej 433.99 euro, e të cilën pagë vazhdon të realizoj edhe sot, në atë mënyrë që i pandehuri në kundërshtim me nenin 8 par. 1 të Ligjit të Punës me nr. 03/L-212, pa konkurs publik, ka pranuar në punë punëmarrësen A. B., duke themeluar marrëdhënie të punës në bazë të kontratës së punës për mësimdhënëse me nr. protokollin .../..të dt. 30.09.2021, në Shkollën Fillore “Z.Z.” fsh. K. K.I, e cila mësimdhënëse fillimisht është pranuar si mësimdhënëse në Shkollën Fillore “M.A.” në fsh. Sh. K. I, në bazë të kontratës së punës me nr. protokollin .../.. të dt. 25.09.2020, duke filluar nga data 16.09.2020, e deri sa të kthehet mësimdhënësjja N. S. B. nga pushimi i lehonisë, dhe deri sa kontrata në fjalë ende nuk ka përfunduar, i pandehuri për të njëjtën mësimdhënëse merr vendim nr.../.. të dt.

04.12.2020, të cilën mësimdhënëse e transferon në Shkollën Filllore “Z. Z.” në fsh. K. K.I., zëvendësim deri sa të kthehet mësimdhënësjë R. U. nga pushimi mjekësor, e më së largu deri me datën 31.08.2021 dhe për këtë pozitë mësimdhënëses i lëshohet kontrata e punës për mësimdhënëse nr.../.. të dt. 04.12.2020, me crast mësimdhënësjë R. U. si pasojë e sëmundjes vdes, ashtu që i pandehuri pa shpallë konkurs publik, pranon dhe themelon marrëdhënien e punës për mësimdhënësen A. B. e cila edhe tani është duke punuar në pozitën dhe Shkollën e njëjtë në bazë të kontratës së punës për mësimdhënëse me nr. protokoll .../..të dt. 30.09.2021, në afat të pacaktuar.

- me çka ka kryer veprën penale “**Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar**” nga neni 414 par. 1 të KPRK-së.

Andaj në aplikim të nenit 7, 8 par. 1, 17, 21 par. 2 38, 39, 42, 43, 44, 69, 70, 71, 72, 414 par. 1 të KPRK-së, si dhe neni 245, 246, 248 par. 1 dhe 4, 360, 365, 366, 453 par. 1 të KPPRK-së, të njëjtin e:

G J Y K O N

I. Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit, konform neni 44 të KPRK-së, i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej tre mije e gjashtë qind (3,600.00) euro, e të cilin dënim duhet ta paguaje në afat prej nëntëdhjete (90) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Nëse i pandehuri refuzon, dështon apo nuk dëshiron ta paguan dënimin me gjobë, i njëjti do ti zëvendësohet me dënim burgimi duke i llogaritur shumen prej njëzete (20) euro për një (1) ditë burgimi.

III. Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, të paguaj shumën prej tridhjetë (30) euro si dhe shumen prej pesëdhjetë (50) euro për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

IV. Kërkese pasurore juridike nuk kishte.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda me datën 25.01.2023 ka ngritur aktakuzën nën shenjen PP/I Nr. 320/22 kundër të akuzuarit H. Sh. nga fsh. K., K. I., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 414 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata me datën 16.02.2023 ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale, në të cilën kanë qenë prezent Prokurorja e Shtetit nga Prokuroria Themelore në Pejë Valbona Disha Haxhosaj, i pandehuri H. Sh. si dhe mbrojtësi i tij av. Haxhi Sinanaj, i angazhuar sipas autorizimit.

Në seancën e shqyrtimit fillestar, i pandehuri fillimisht është njoftuar me të drejtat e tij nga neni 246 par. 1 të KPPRK-së, dhe i njëjti ka deklaruar së e ka kuptuar të drejtat e tij dhe së për mbrojtës ka angazhuar av. Haxhi Sinanaj, me të është konsultuar paraprakisht dhe nuk kanë nevojë për konsultë shtesë.

Pas konstatimit të aktakuzës nën shenjen PP/I Nr. 320/22 dt. 25.01.2023 si e lexuar me pëlqimin e palëve në procedure, Kryetari i trupit gjykues është i bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe të akuzuarit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për fajësinë apo pafajësinë, duke e udhëzuar paraprakisht me kushtet, privilegjet dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

I akuzuari H. Sh. ka deklaruar se i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e fajësisë dhe në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije **e pranon fajësinë**, për veprën penale për të cilën është akuzuar.

Prokurorja e shtetit në lidhje me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit H. Sh. ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit H. Sh. meqenëse një pranim korrespondon edhe me prova në bazë të cilave është ngrit aktakuza andaj i propozoj gjykatës që ta aprovon.*

Mbrojtësi i të pandehurit av. Haxhi Sinanaj në lidhje me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit H. Sh. ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë së këtu të mbrojturit tim H. Sh., e për veprë penale të cekur si në aktakuzë, një pranim i tillë i fajësisë është i vullnetshëm, pa asnjë lloj ndikimi dhe i njëjti është bërë pas konsultimeve të mjaftueshme që unë si mbrojtës kam pasur me te, duke ja shpjeguar të gjitha pasojat por edhe benefitet e pranimit të fajësisë, ashtu që duke u gjendur para provave të cekura si në akuzë i propozoj gjykatës që të aprovon pranimin e fajësisë.*

Kryetari i trupit gjykues ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit H. Sh., i bindur se pranimi i fajësisë është bërë në përmbushje të kushteve ligjore të nenit 248 par. 1 nën par. 1.1 e deri nën par. 1.4 të KPPRK-së, i cili pranim i fajësisë po ashtu ka mbështetje edhe në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, siç janë: *Raporti informues nga Njësiti për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit me nr. DHKEK/.../22 i dt. 29.09.2022, kontrata e punës me nr. protokolli .../20 e dt.25.09.2020, Kontrata e punës me nr. protokolli .../21 dt.30.09.2021, deklarata e L. N., Vendimi nga Drejtoria Komunale e Arsimit nr. /20 e dt. 04.12.2020, kontrata e punës me nr. protokolli .../20 e dt. 04.12.2020, përzgjedhja e kandidatëve për konkursin nr. .../20 i dt. 29.07.2020, kërkesa për punësim sipas konkursit 05.nr.223/20 e dt.29.07.2020, konkursi nga Drejtoria Komunale e Arsimit në I. me nr. 05.nr.223/20 i dt. 29.07.2020, raporti zyrtar nga Inspektorati i Punës me nr.../2022 i dt. 23.11.2022, raporti i policit nga rr. S. I. me nr. 2022-KE-... i dt.12.12.2022, listën e pagave për dëshmitaren A. B., dhe mbi këtë është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë dhe për këtë është vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 326 par. 4 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të pandehurit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 248 par. 4 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.*

Prokurorja e shtetit në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese ka deklaruar se: *sa i përket të kaluarës kriminale për të pandehurin H. Sh. prokuroria nuk ka të dhëna që i njëjti ka qenë i dënuar për ndonjë veprë penale por ju si gjykate mund të vërtetoni në baze të dhënave që posedoni në data bazën e personave të dëmtuar. Meqenëse i pandehuri H. Sh. e pranoi fajësinë, i cili veprimet e tij e ka pranuar edhe në prokurori por me arsyetimin se ka qenë kohë pandemie, procedurat për shpalljen e konkursit kishin marr një kohe të gjatë, ka vepruar ashtu siç deklaroi edhe sot, andaj unë mbes në tërësi pranë aktakuzës, përshkrimin faktik dhe juridik të veprës penale, dhe i propozoj gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit. Me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit i propozoj gjykatës që si rrethana*

posaçërisht lehtësuese të vlerësojë pranimin e fajësisë, i cili pranim është bërë edhe ne prokurori me arsyetimin si me larte por edhe sot gjatë shqyrtimit gjyqësor, po ashtu si rrethane lehtësuese gjykata ta vlerësojë edhe sinqeritetin e të pandehurit, kurse rrethana renduese ta vlerësojë faktin se me veprimin e të pandehurit është mohuar mësimdhënësve apo kandidatëve të tjerë për mësimdhënës aplikimi apo punësimi ne baze të konkursit të rregullt, kurse rrethana tjera nuk kam gjetur.

Mbrojtësi i të pandehurit H. Sh., av. Haxhi Sinanaj në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese ka deklaruar së: *me rastin e marrjes se vendimit mbi dënim si rrethana lehtësuese, e posaçërisht lehtësuese i propozoj gjykatës që të merr se i akuzuari vullnetarisht ka pranuar fajësinë në të gjitha fazat e procedurës penale, është hera e para që ka ra ndesh me ligjin, është familjar, i njëjti ka qenë korrekt gjatë gjithë procedurës dhe ka shpreh keqardhje për rastin që ka ndodhur, ashtu që i propozoj gjykatës që ndaj të njëjtit të shqiptohet një dënim sa më i butë dhe atë të kushtëzuar apo gjykata të aplikoje nenin 72 par. 1 pika 1.5 të KPK-së për zbutje të dënimit ashtu që të njëjtit ti zbutet dënimi gjer ne 3 apo 6 muaj e pastaj që i njëjti me pëlqimin e të akuzuarit ti shndërrohet në dënim gjobë e me të cilin dënim do të arrihet efekti i ndëshkimit.*

I pandehuri H. Sh. ka deklaruar se: *e mbështes në tërësi deklarinimin e mbrojtësit tim, dua të shtoj se ky veprim i imi është ndërmarr vetëm me qëllim që nxënësit mos ta hupin mësimin, jam penduar shume, me vjen keq, i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do ta përsëris veprimet e tilla, lus gjykatën që të me shqiptojë një dënim sa më të butë.*

Me faktet e ofruara ne shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv te këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 414 par. 1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se te i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Kryetari i trupit gjykues në aplikim të neneve 69 dhe 70 të KPRK-së, i vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe renduese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ashtu që si rrethana lehtësuese gjeti se i pandehuri ka pranuar fajësinë në mënyrë të vullnetshme, sinqeritetin e tij deklarues, keqardhjen e shfaqur në mënyrë publike, pendimin e tij për veprën e kryer, premtimin e tij së në të ardhmen nuk do të përsërit veprimet e tilla, mosednueshmerine e tij të mëparshme të cilën gjykata edhe e vërtetoi në data bazën e të dhënave, ndërkaq nga rrethanat renduese për të akuzuarin e lartcekur gjykata në rastin konkret gjeti faktin së me veprimet e tij, personave të tjera iu është mohuar e drejta në punësim në bazë të konkursit të rregullt.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KPRK-së.

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit për veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 414 par. 1 të KPRK-së, ka aplikuar dispozitat të cilat kanë të bëjnë me zbutjen e dënimit, e krejt kjo duke pasur parasysh rrethanat veçanërisht lehtësuese të cekura si më lartë, ashtu që duke vepruar konform dispozitave ligjore të nenit 71 dhe 72 par. 1, nën par. 1.5 të KPRK-së, e ku përcaktohet se, *“nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej një (1) viti, dënimi mund të zbutet deri në tre (3) muaj burgim”* ashtu që gjykata të njëjtit i ka shqiptuar dënimin me burgim nder minimumit të parapare ligjor në aplikim të këtyre dispozitave.

Gjykata pati parasysh edhe rrethanën renduese të cekur si më lartë, me rastin e marrjes së vendimit mbi dënim, mirëpo në raport me rrethanat lehtësuese gjykata erdhi në përfundim se të njëjtat mbizotërojnë në raport me këtë rrethanë, andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për shqiptimin e dënimit me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, e i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, i konstatuar në procesverbal të shqyrtimit fillestar të dt. 16.02.2023, është zëvendësuar në dënim me gjobë në shumë prej tre mije e gjashte qind (3,600.00) euro, u morr konform nenit 44 të KPRK-së, pasi që i akuzuari dhe mbrojtësi i tij edhe në fjalën përfundimtare kanë dhënë pëlqim për një gjë të tillë.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit të dënimit të shqiptuar me gjobë në dënim burgimi do merret në aplikim të nenit 43 par.3, të KPRK-së, në rast së i pandehuri nuk e paguan, refuzon apo dështon ta paguaj dënimin me gjobë e shqiptuar si në piken I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u morr në bazë të nenit 453 par.1 lidhur me nenin 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 të KPPRK-së.

Vendimi për taksat e kompensimit të viktimave të krimit, u morr në bazë të qarkores për zbatimin e ligjit Nr. 05/L-36.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPRK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.17/23 dt. 21.02.2023

Zyrtari ligjor,
Alan Taranish

Kryetari i trupit gjykues,
Dr.sc. Murat Hulaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e marrjes, drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë e përmes kësaj gjykate. Kjo për faktin së procedura penale dhe shpallja e aktgjykimit me dt. 16.02.2023 është bërë sipas Kodit të Procedurës Penale 04/L-123, ndërsa Kodi i ri i Procedurës Penale 08/L-032 ka hyrë në fuqi me dt. 17.02.2023, dhe bazuar në dispozitat kalimtare dhe përfundimtare, afati i ankesës sipas këtij Kodi rrjedh sipas nenit 542 të Kodit të Ri të Procedurës Penale.